



RREGULLORE E SHOQATËS

„Mërgimtarët e Sllupcanit“



Shoqata Mërgimtarët e Sllupcanit me Selin në Zvicër

EMRI DHE VENDI

Neni 1:

a). Shoqata "Mërgimtarët e Sllupcanit" është themeluar me datën 14. Qershor 2020 te Xhamia në Flums të Zvicres.

b). Shoqata "Mërgimtarët e Sllupcanit" është një shoqatë e bazuar në Nenin dhe Statusin e Shoqatës në përputhje me ligjet egzistuese në Republikën e Zvicres.

c). Selia e Shoqatës Mërgimtarët e Sllupcanit gjendet në Qytetin të Zvicres.

Adresa:

Tel.:

E-Mail:

SYNIMI I SHOQATËS

Neni 2:

a) "Shoqata" Mërgimtarët e Sllupcanit "Synon që çdo veprimtar të saj të bëjë vetëm brenda Fshatit Sllupcan.

b). Synon përkrahjen e projekteve që ndërmerren në Fshatin Sllupcan.

c) .Synon stimulimin e Arsimit dhe Aktiviteteve Kulturore në Fshatin Sllupcan.

d) .Ndhmon Familjet me varfëri të skajshme të Fshatit Sllupcan.

e) .Synon që për çdo Kërkesë apo ndihmë të çfarëdo lloji, të ndermiren aksionë Vullnetare të Fshatarëve të Fshatit Sllupcan.

f). Nuk ka qëllim përfitime individuale dhe është neutrale ndaj Politikës.

STRUKTURA E SHOQATËS

Neni 3:

a). Shoqata përbëhet nga Antarët e Shoqatës dhe Kryesia.

ANËTARËSIA

Neni 4:

- a). Anëtarë mund të bëhet secili person që mbështet qëllimet e "Shoqatës Mërgimtare e Sllupcanit"
- b). Çdo Antarë është i obliguar të pagujë Antarsin Vjetore "120 Frank".
Ky vendim është marr në Mbledhjen e përgjithshme të Antarëve në Flums me 14.06.2020.
- c). Afati i pagesës për Vitin 2020 deri më Dhjetorë
- d). Afati i pagesës për Vitet e ardhëshme der në 31. Mars.
- e). Arkatari bën kontrollimin e pagesave.
- f). Anëtari ka përparsi në shërbimet që ofrohen në Shoqat.

KRYESIA

Neni 5:

- a). Kryesia duhet të veproj në përputhshmëri me Rregulloren, dhe nuk guxon të dalë jashtë normave të saj, Antarët e Kryesisë duhen të jenë me origjin të Fshatit Sllupcan.
- b). Mandati i Antarëve të Kryesisë zgjatë 2 Vjet.
- c). Dorëheqja eventuale e ndonjë Anëtari të Kryesisë duhet të bëhet me shkrim dhe të informohen Anëtarët.
- d). Kryesia para dhe pas çdo Mbledhje duhet të takohet me të gjithë Anëtarët e Kryesisë që të mbajnë parambledhje ku do të merren vendime dhe do të diskutohet dhe bëhen përgatitjet për Mbledhjen e ardhëshme, dhe caktohet rendi i Mbledhjes dhe kush do ta udhëheq Mbledhjen dhe të diskutohen rezultatit i Mbledhjes dhe kërkesat e Anëtarëve.
- e). Sekretari e ka për detyrë ta Lajmëroj Mbledhjen e përgjithshme për mes rrjeti Social ose në Sms" së shpalljeve, së paku 4 javë para mbajtjes së saj, ku do të njohet edhe me pikat e rendit të Mbledhjes.
- f). Arkatari çdo hyrje dhe dalje nga Kontoja e Shoqates duhet të vulozet dhe të nënshkruhet prej Arkatarit, Kryetarit dhe Sekretarit
Nuk lejohet të dal nga buxheti i Shoqatës apo të hyjë pa vërtetim (pa vulë dhe nënshkrim).
- g). Nëse ndonjë Anëtar i Kryesisë vendos vet apo merr ndonjë iniciativë vet largohet nga Kryesia pa marrë parasysh pozitën e tij në Kryesi.

- h). Procesin verbal e mban Sekretari, ose ndonjë person i caktuar (i Anëtarve), kurse procesverbalin e verifikojn dy verifikues.
- i). Kryetari mund të kontrolloj punën e secilit Anëtarë të Kryesisë.
- j). Kryesia nuk mund të veproj në kundërshtim me Rregulloren.
- k). Kryesia nuk ka të drejtë të ndihmoj apo të ju jepë borxhë as Anëtarit, e as joanëtarit prej Kontos së Shoqates.
- l) Kryesia e Shoqates nuk ka të drejt të merr të Holla nga Shoqata

ANTARET E KRYESYS

Neni 6:

Secili Anëtarë i Kryesisë, mund të përjashtohet nëse konstatohet se:

- a). Nuk e kryen detyrën për të cilën është zgjedhur.
- b). Nuk përfill parimet e përgjithshme njerëzore.
- c). E keqpërdor pozitën e vet në dëm të interesave të Shoqatës.
- d). Shfaqet paaftesia e tij për të kryer detyrën për të cilën është zgjedh.
- e). Mungon pa ndërprerje gjatë mandatit të tij më shumë se 1/3-ën kohëzgjatjes mandatit.
- f). Nëse konstatohet keqpërdorim Financiar, ndjeket edhe penalisht në bazë të ligjit Zvicran.

REVIZORET

Neni 7:

- a). Revizoret përbehen prej 2 Anëtarëve që zgjidhen në Mbledhje të përgjithshme me Anëtarët.
- b). Revizoret duhen të komunikojn dhe të bashkëpunojnë ngushtë me Kryesinë e Shoqatës.
- c). Detyra e Revizorit, është Mbikqyrja e punës së Arkatarit.
- d). Ka përgjegjësinë Kontrollimin Financiar të Shoqates së paku në cdo 3 muaj njëherë, apo ne rastë të dyshimit të bazuar për ndonjë keqpërdorim mund të bëhet menjëherë. Në Mbledhjen e radhës të njoftoj Anëtarët me rezultatin e Kontrollimit Financiar.
- e). Revizoret duhen të Informojnë Kryesinë e Shoqatës për Kontrollimin së paku 2 jave për para.

MBLEDHJET E KRYESISE

Neni 8:

- a). Mbledhje të përgjithshme me të gjithë Anëtarët të mbahen 4 herë në Vitë me qëllim të Informimit të Anëtarëve.
- b). Në raste urgjente , apo nëse paraqitet nevoja mbahet Mbledhje e crregullt. Vendimin për mbajtjen e Mbledhjeve të crregullta e merr Kryesia.Mbledhje e crregullt mbahet edhe nëse e kërkon një numer 1/5 e Anëtarëve.
- c). Mbledhja udheheqëse të Shoqatës, Kryesia e Shoqatës,Revizoret kanë për detyrë të mbajnë Mbledhje të përbashkët një herë në Vit.Terminin e Mbledhjes e bënë Kryesia e Shoqatës dhe Sekretari bënë shpalljen 1 muaj para afatit të Mbledhjes.

PERBERJA E KRYESIS

Neni 9:

- a) .Kryesia (7 Persona)
- b). Revizor (2 persona)

NËNDEGAT JASHT ZVICRES

Neni 10:

- a). Qendra e Shoqates Mërgimtare e Sllupcanit është në të Zvicres dhe kjo Shoqat dotë ketë Nëndega në mbar Boten.
- b). Nëndegat që do të Formohen në vende të tjera si në Evërop apo anemban Botes jan të Obliguar të Bashkepunojn ngusht me Kryesin e Shoqatës të Mërgimtare e Sllupcanit në Zvicer dhe se bashku te marrin vendim te perbashkët per Investimet të cilet ne të ardhmen do të Investohet ne Fshatin Sllupcan.
- c). As një Kryesi apo Nëndegë nuk kanë të drejt në të ardhmen të marrin llojë vendimesh per Investimet në Fshatin Sllupcan pa u konsulltu dhe miratu vendimi i përgjithshëm i Shoqates apo Kryesit që jan për momentin në Funkzion gjithëashtu dhe të Informohen Antaret ne Mbledhjen e radhes.
- d). Informimi /Lajmrimet apo Konsulltimi bëhet mes rrjetit Social ose për mes sms shkrimit dhe Mbledhjeve te radhes.

MBLEDHJE ME TË GJITHË ANËTARËT E SHOQATËS

Neni 11:

- a). Kërkesat për diskutim e një teme të caktuar në Mbledhjen duhet ti dorëzohen Kryesisë më së paku 1 javë para Mbëledhjes së përgjithshme, duhe të behet publike më së paku 4 jav më herët, njëkohsisht edhe temat e Mbledhjes.
- b). Në mbledhjen e përgjithshëm, çdo Anëtarë ka të drejtë të zgjidhet, të Votoj dhe ka të drejtë për kërkesë.
- c). Për kërkesat dhe Zgjedhjet Votohet ne menyrë të hapur, por nëse nuk është caktuar më herët për një Votim të mbyllur,(Shumica e thjeshtë e Anëtarëve të pranishëm).
- d). Për çdo Votim (duke përjashtuar revizionin e Statutit dhe Zgjedhjen e një Pozite), vendosë shumica e Antarëve të pranishëm.
- e). Për zgjedhjen e një Pozite, në Votimin e parë vendosë shumica absolute, në Votimin e dytë shumica e Anëtarëve.
- f). Mbledhje me Anëtarët e Shoqatës ,mbahen 4 herë ne Vitë,apo edhe më shumë se 4 herë, nëse vendos Kryesia e Shoqatës.
- g). Në Mbledhje me Anëtarët kanë të drejt të marrin pjesë vetëm Anëtarët e rregullt , apo ata që janë të liruar prej Kryesisë së Shoqatës dhe Revizorve.Sekretari ka për detyrë verifikimin e Anëtarëve Pjesëmarrës në Mbledhje.
- h). Po ashtu në Mbledhje kanë të drejt të marrin pjesë Musafirë apo Anëtarët e Bashkësis së Fshatit Sllupcan dhe Këshilltarët e Fshatit Sllupcan .
- i). Gjatë Mbledhjeve ndalohet pirja e duhanit në sallën ku mbahet Mbledhja.
- j). Anëtarët duhen të kujdesen të mos bëjnë Zhurmë, nëse dëshirojnë të marrin Fjalën,duhet kërkojnë Fjalën, të prezantohen, dhe ti përmbahen rendit të Mbledhjes.
- k). Kujdestarin gjatë kohës së Mbledhjes e mbajnë Revizoret, dhe në rast ndonjë pjesëmarrës e prish rendin e Mbledhjes kanë të drejt ta largojnë nga Mbledhja.

ADMINISTRATA

Neni 12

- a). Në Mbëledhjet e Përgjithshme dhe takimet e Kryesisë duhet të Mbahet një Protokoll (Procesverbal)dhe këtë e ka per detyr Sekretari.

FINANCAT

Neni 13

- a). Viti i Shoqatës për Financa përfundon në Ditën e Fundit të Vitit Kalendarik.
- b). Të Hyrat e Shoqatës përbëhen posaqërisht nga:

1. Antarësia

- 2. Fitimet nga Aktivitetet e ndryshme
- 3. Pagesat Vullnetare dhe dhuratat
- 4. Sponzorët

REVIZIONI

Neni 14

- a). Ndryshimet në Statut dhe Rregullore mund të bëhen vetëm në Mbledhjen e Përgjithshëm me shumicën absolute e të Pranishmëve me të drejtë Vote.
- b). Shuarja Bashkimi dhe përshtatja e Synimit të Shoqatës mund të bëhet vetëm në Mbledhjen e Përgjithshëm me shumicën Absolute e të pranishmëve me të drejtë Vote.
- c). Nëse në rast shuarje të shoqatës e gjithë Pasuria e Shoqatës do ti ipet " Xhamisë së Fshatit Sllupcan", Shkollës së Fshatit Sllupcan ose të varfërve të Fshatit, në rast të shpërbërjes së Shoqatës, përjashtohet çfarëdo ndarje e mjeteve mes Anëtareve të Shoqatës.
- d). Statuti hyn në Fuqi në pas miratimit të shumicës absolute të Pranishmëve në Kuvendin Themelues, me Date 2020,

Ju prshëndet me respekt Kryesia e Shoqates

„Mërgimtarët e Sllupcanit“